



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2018, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E OBELISKUT KUSHTUAR**  
**50-VJETORIT TË DEMONSTRATAVE TË VITIT 1968 NË KOSOVË**

- I. **MIRATOHET** Vendimi për vendosjen e Obeliskut kushtuar 50-vjetorit të Demonstratave të vitit 1968 në Kosovë, në sheshin "Edit Durham" në Prishtinë.
- II. Lokacioni për vendosjen e Obeliskut kushtuar 50-vjetorit të Demonstratave të vitit 1968 në Kosovë, shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale nr. 6219-0, ZK Prishtinë, në pronësi - pronë shoqërore, KK Prishtinë.
- III. Ky vendim paraqet bazë për lejimin e vendosjes së këtij obelisku përkujtimor.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lokacioni i propozuar në 3D, ortofoto e lokacionit dhe obelisku i propozuar.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-353/02-263777/18, më 01.11.2018

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta



## ARSYETIM

### I Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e Obeliskut kushtuar 50-vjetorit të Demonstratave të vitit 1968 në Kosovë

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm ka shqyrtuar kërkesën nr. 14-353/02-0249210/18, dt.15.10.2018, drejtuar Kryetarit të Komunës nga Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, për vendosjen e Obeliskut kushtuar 50-vjetorit të Demonstratave të vitit 1968 në Kosovë.

Me rastin e shënimit të 50-vjetorit të Demonstratave të vitit 1968 në Kosovë, Shoqata në bashkëpunim me Institutin e Historisë dhe Institutin Albanologjik, do të organizojë aktivitete të ndryshme në qytetet ku janë zhvilluar demonstratat.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, sipas kërkesës së lartcekur nga Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës dhe në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie, ka identifikuar lokacionin për vendosjen e Obeliskut kushtuar 50-vjetorit të Demonstratave të vitit 1968 në Kosovë, i cili gjendet në kuadër të Planit zhvillimor urban, i miratuar me Vendimin e KK së Prishtinës 01, nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, sipas të cilit kjo zonë është paraparë të jetë për ndërtim të lartë të përzier.

Lokacioni i propozuar shtrihet në parcelën kadastrale nr. 6219-0, ZK Prishtinë në pronësi - pronë shoqërore, KK Prishtinë.


Vendosja e Obeliskut në fjalë është propozuar të vendoset në sheshin "Edit Durham" në Prishtinë, andaj në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë për caktimin e lokacionit sipas kërkesës së Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës.

Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se hapësira ku do të vendoset obelisku është sipërfaqe e gjelbëruar, andaj gjatë vendosjes së obeliskut duhet t'i kushtohet kujdes të veçantë ambientit. Propozohet të vendoset në mes të oazës dhe sa i përket madhësisë, formës dhe materialit, është përcaktuar në kërkesën e parashtruar.


#### **Bashkëngjitur:**

- - Lokacioni i propozuar në 3D,
- Ortofoto e lokacionit,
- Obelisku i propozuar.





Lokacionit i propozuar në 3D;



Ortofoto e lokacionit;





Obelisku i propozuar ( foto ilustruese );

